



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 526/25 Dt. 05.09.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti


Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Memorandumit të plotësuar të Mirëkuptimit, 01 nr. 508/25 datë 29.08.2025 për financimin e projektit infrastrukturor në Komunën e Prizrenit, i nënshkruar mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të projektit: “Projekte infrastrukturorë të Zhupës dhe Podgorit-asfaltimi i rrugës Skorobisht-Kopana Voda”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nr. 16205.
3. Ky projekt realizohet konform Memorandumit të plotësuar të Mirëkuptimit, (protok. KKPZ 01 nr. 508/25 datë 28.08.2025 dhe protok. MMPHI nr. 7978 datë 27.08.2025) për financimin e projektit infrastrukturor në Komunën e Prizrenit, i nënshkruar mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Toraj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - MMPHI,
 - Arkivës së Kryetarit.